



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 652, datë 02.12.2014

“PËR MIRATIMIN E MODELIT TË KONTRATËS DHE MODALITETET E LIDHJES SË SAJ NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 763, DATË 12.11.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA, TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR VITIN AKADEMIK 2014 – 2015””

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të pikës 13, të vendimit nr. 763, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit dhe tarifave të shkollimit, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2014 – 2015”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të kontratës në zbatim të pikës 13, të vendimit nr. 763, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit dhe tarifave të shkollimit, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2014 – 2015”, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sektori i Redaktimit Gjuhësor dhe Arkiv Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

NASIP NAÇO

(Në mungesë dhe me porosi)

ZËVENDËSMINISTRI

ARBEN ISARAJ

Ar